



NJOFTIM PËR VENDE TË LIRA PUNE PËR STAF ADMINISTRATIV

Pozicioni: Specialist i Zyrës së Kurrikulës dhe Cilësisë

Fusha specifike: Te ndryshme

Tipologjia: Me kohë të plotë

Data e fillimit: Shtator 2021

Afati i aplikimit: 30.08.2021

Universiteti Metropolitan Tirana është një universitet i çertifikuar nga MASR i përbërë nga tre fakultete, Inxhinieri dhe Arkitekturë, Fakulteti i Ekonomisë dhe Fakulteti i Shkencave Kompjuterike dhe IT. Numri i përgjithshëm i studentëve në UMT është rreth 1000, numër i cili ka pësuar një rritje të ndjeshme në dy vitet e fundit.

I klasifikuar si një nga universitetet më të mirë në Shqipëri, një rëndësi të veçantë i është dhënë kohët e fundit krijimit të një ekosistemi ndërmarrjesh, inovacionit pedagogjik si dhe strukturimit të aktiviteteve shkencore rreth shkollave të doktoraturës në bashkëpunim me institucione dhe kolegë nga Evropa dhe USA. Një rëndësi të veçantë i është dhënë internacionalizimit të aktiviteteve pedagogjike nëpërmjet një sërë marrëveshje me universitete evropiane dhe projektet Erasmus në mbështetje të mobilitetit të studentëve. Gjithashtu po i jepet një rëndësi e veçantë nënshkrimit të marrëveshjeve me ndërmarrjet evropiane dhe vendase për mbështetjen e aktivitetit pedagogjik dhe shkencor si dhe punësimin e studentëve të UMT.

Universiteti Metropolitan Tirana rekruton për pozicionin Specialist i Zyrës së Kurrikulës dhe Cilësisë në Rektoratin e Universitetit të Metropolitan Tirana

Ju jeni mbajtës i diplomës të nivelit “Master i Shkencave” ose ekuivalente me të (DIND), jeni njohës i të paktën një gjuhe të huaj dhe zotëroni gjuhën shqipe të shkruar dhe të folur, nuk jeni dënuar me vendim të formës së prerë të gjykatës për kryerjen e një veprë penale dhe keni vlerësime pozitive të përvojave të mëparshme të punës.

Ju zotëroni aftësitë e nevojshme profesionale, keni eksperiencë pune në fushën e kurrikulës dhe të sigurimit të cilësisë të programeve të studimit dhe atë institucional dhe gjithashtu shfaqni aftësi organizative dhe bashkëpunimi në grup atehere ju jeni kandidati i duhur për pozicionin e lirë të punës si specialist i Zyrës së Kurrikulës dhe Cilësisë.

Mënyra e vlerësimit:

Përzgjedhja e kandidatit fitues do të bëhet nëpërmjet konkurrimit me dosje dhe me intervista të drejtpërdrejta.

Fusha e njohurive, aftësive dhe cilësive mbi të cilat do të zhvillohet intervista:

Njohuri mbi ligjin nr. 80/2015, datë 22.07.2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në IAL në RSH”; Njohuri mbi aktet nënligjore të arsimit të lartë lidhur me programet e studimit, pranimet në programe studimi, standardet shtetërore të cilësisë, si dhe Kodin e Cilësisë.

Në intervistë, kandidatët do të vlerësohen për njohuritë mbi legjislacionin e sipërcituar, aftësitë, kompetencat, eksperiencën e tyre të mëparshme, motivimin, aspiratat si dhe pritshmërinë e tyre për karrierën.

Përshkrimi i punës:

Përgatitja e dokumentacioni për hapjen/riorganizimi/mbylljen e programeve të studimit si dhe të procesit të vlerësimit të brendshëm të cilësisë (institucional dhe programesh) për NJSBC dhe Senatin Akademik.

Përpunimi i propozimeve të njësive kryesore lidhur me kuotat dhe kriteret e pranimit në programet e ciklit të parë, të integruar të ciklit të dytë, të ciklit të dytë dhe të ciklit të tretë të studimeve të UMT. Përgatitje për Senatin Akademik të UMT.

Ndjek dhe monitoron procesin e pranimeve në njësitë kryesore të UMT, në përputhje me kuotat e miratuara dhe kriteret e pranimit të miratuara me parë si dhe në zbatim të akteve ligjore dhe nënligjore në fuqi.

Përgatit dokumentacionin për emërtimet e diplomave për ciklin e parë, të dytë dhe të tretë të studimit në zbatim të akteve ligjore dhe nënligjore në fuqi.

Monitoron pajisjen me numër matrikullimi të studentëve të cilët regjistrohen për herë të parë në UMT, në zbatim të akteve ligjore dhe nënligjore në fuqi.

Merr pjesë në draftimin e analizës vjetore mësimore kërkimore shkencore dhe financiare të UMT, bazuar në analizat vjetore të njësive kryesore të UMT (nivel Rektorati), kryesisht për programet e studimit dhe cilësinë në UMT

Trajton shkresat që vijnë nga institucionet me të cilat UMT ndërvepron (sipas detyrës), në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi.

Për çdo paqartësi mund të dërgohet email në adresën **humanresources@umt.edu.al**.

Kandidatët konkurrentë duhet të dërgojnë në format elektronik këtë dokumentacion:

- Kërkesë me shkrim.
- CV (Curriculum Vitae)
- Kopje e diplomës dhe listës së notave të nivelit “Master i Shkencave” Për diplomat e marra në universitetet e huaja, duhet të dorëzohet fotokopje e noterizuar e çertifikatës së njohjes nga organi kompetent (MASR), ose vërtetim që janë në proces njohje.

Aplikimet duhet të dorëzohen me e-mail në humanresources@umt.edu.al